

THIRRJE PËR OFERTË

Hulumtim/Analizë për gjendjen mjedisore në komunën e Prizrenit

Programi për të drejtat e njeriut, "HUMAN RIGHTIVISM", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për realizimin e **Hulumtimit/Analizës së gjendjes mjedisore në komunën e Prizrenit**.

Dokumenti duhet të përmbajë analizë të thellë të gjendjes mjedisore në komunën e Prizrenit, duke përfshirë analizën e legjislacionit, strategjive dhe dokumenteve tjera relevante në nivel qendror dhe lokal. Qëllimi i kësaj analize është identifikimi i problemeve, vështirësive dhe nevojave mjedisore të Komunës së Prizrenit dhe përkthimi i tyre në rekomandime konkrete dhe të zbatueshme.

Raporti përfundimtar i hulumtimit, i cili duhet të shërbejë në përmirësimin e të drejtave të njeriut, duhet të përmbajë përmbledhje të strukturuar që përfshin të gjithë parametrat mjedisorë, si një informacion i bazuar për të ushqyer politikat lokale (dhe qendrore) si dhe furnizuar gazetarët dhe aktivistët me detaje të rëndësishme për punën e tyre avokuese.

Gjatë hartimit/zhvillimit të hulumtimit/analizës, pala e angazhuar duhet së paku të organizoj takime me përfaqësues të komunës/drejtorive përkatëse për t'i njoftuar për qëllimin e analizës/hulumtimit. Takimi i palëve të mësipërme për të diskutuar draftin e dokumentit është i obligueshëm.

Afati për përfundim të dokumentit

15 Maj 2020

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së), CV-të e personave që do të angazhohen për realizimin e aktivitetit;

- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtë të metodologjisë së hulumtimit/analizës duke ofruar së paku informata mbi dokumentacionin që do të analizohet, palët që do të përfshihen/kontaktohen dhe strukturën e propozuar të dokumentit. Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyrat e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më datë 27.03.2020, ora 15:00 me shënim: *“Hulumtim/analizë për gjendjen mjedisore në komunë e Prizrenit”*. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: info@ecmandryshe.org deri më datë 23.03.2020.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertet/ grupi i ekspertëve/ kompanitë / OJQ, nëse këto e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Për më shumë informacione rreth kësaj thirrjeje për aplikim, ju lutemi vizitoni www.ecmandryshe.org/konkurse.